

**Vendim nr. 222 datë 08.10.2024**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, në datën 08.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **MEDI KOLECI**

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4098 (626), datë 19.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 41, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Medi Koleci është pronar i tokës arë me sipërfaqe 5430 m<sup>2</sup>, fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndodhur në fshatin Armath të qarkut Durrës. Në këtë fshat ish- Bashkia Sukth e qarkut Durrës ka ndërtuar një depo uji, shkak për të cilin mes saj dhe kërkuesit ka lindur konflikt, ndërsa ky i fundit ka pretenduar se depoja është ndërtuar mbi

pronën e tij. Për këtë arsye ai i është drejtuar prefektit të qarkut Durrës për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Prefekti i qarkut Durrës, me shkresën nr. 913/1 prot., datë 25.10.2011, ia ka referuar rastin për trajtim ish-Bashkisë Sukth. Kjo e fundit, me shkresën nr. 1059 prot., datë 11.11.2011, ka sqaruar kërkuesin se nga verifikimet, matjet dhe krahasimi me hartën treguese të pronës së tij depoja e ujit, e ndërtuar me fondet e asaj bashkie, nuk binte në pasurinë e tij, por në një pasuri tjetër, e cila ishte pronë publike.

2. Në datën 27.02.2012, duke mos qenë dakord me sqarimin e bërë nga ish-Bashkia Sukth, kërkuesi ka paraqitur në gjykatë një kërkesëpadi me objekt detyrimin e asaj bashkie ta njohë pronar për sipërfaqen e tokës së zënë prej 1498,2 m<sup>2</sup>, e cila ndodhet brenda sipërfaqes 5430 m<sup>2</sup> pronë e tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 416 (11-2013-790), datë 13.02.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 723 (10-2014-2857), datë 21.10.2014, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4098 (626), datë 19.07.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin asaj të çështjes për rishqyrtim.

3. Në datën 21.06.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 15.07.2024. Kolegji i Gjykatës, në datën 24.09.2024, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *parimit të sigurisë juridike*, pasi rekursi i palës së paditur është paraqitur jashtë afateve procedurale, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka pranuar atë për shqyrtim dhe në vijim ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtat kushtetuese të kërkuesit. Pas dhënies së vendimit të gjykatës së apelit të datës 21.10.2024, i cili është zbardhur i arsyetuar menjëherë, kërkuesi i është drejtuar ish-Bashkisë Sukth, Ujësjiellës Kanalizimeve Durrës dhe ish-Bashkisë Manëz, me qëllim marrjen e përfitimit që i takonte nga përdorimi i sendit.

## III

## Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

6. Në këtë këndvështrim, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

7. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Ky rregull përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuari, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se objekt i kërkesës në shqyrtim është kundërshtimi i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), por përjashtimisht, ai mund t’i nënshtrohet kontrollit kushtetues nëse natyra e pretendimit të ngritur justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pra nëse shkelja është e tillë që pasojat e saj nuk mund të riparohen më gjatë rigjyimit

të çështjes, në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në themel të kërkesës së tij, kërkuesi ka pretenduar se rekursi i palës së paditur është paraqitur jashtë afatit procedural 30-ditor të parashikuar në nenin 443 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), të cilin Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka pranuar për shqyrtim dhe në vijim ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtat e tij kushtetuese. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se natyra e pretendimit të ngritur nga kërkuesi justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, përderisa shkelja që ai pretendon është e tillë që pasojat e saj nuk mund të riparohen më gjatë rigjykimit të çështjes, në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ai nuk ka mjete të tjera ligjore efektive në dispozicion për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, ndaj legjitimohet për kundërshtimin e vendimit objekt kërkesë.

10. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se në rastet kur kërkuesi ka qenë i izoluar pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEPV), si moment i njohjes efektivisht me vendimin, e lidhur kjo me momentin nga i cili fillon të llogaritet afati ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, do të konsiderohet data në të cilën Gjykata e Lartë i ka vënë në dispozicion vendimin saj (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 45, datë 03.10.2023; nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*),

11. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 19.07.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është depozituar në Gjykatë në datën 21.06.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra pas rreth 11 muajve nga ajo datë. Ndërkohë, rezulton se gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, kërkuesi ndodhej në kushtet e kufizimit të lirisë personale, në IEVP-në, Reç, Shkodër, për efekt të vuajtjes së një dënimi penal të dhënë ndaj tij. Po kështu, rezulton se kërkuesi në datën 27.05.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për informacion për çështjen e tij, në përgjigje të së cilës, me shkresën nr. 2731/1 prot., datë 28.05.2024, Gjykata e Lartë e ka informuar se çështja e tij është shqyrtuar nga Kolegji Civil në datën 19.07.2023, duke i vënë në dispozicion edhe vendimin objekt të ankimit kushtetues individual.

12. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme dhe faktin se kërkuesi në momentin e shqyrtimit të çështjes së tij në Gjykatën e Lartë ka qenë i izoluar pranë IEVP-së, Reç, Shkodër, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se si moment i konstatimit të cenimit të së drejtës do të konsiderohet data 28.05.2024, në të cilën Gjykata e Lartë, përmes shkresës nr. 2731/1 prot., datë 28.05.2024, i ka vënë në dispozicion kërkuesit kopje të vendimit të arsyetuar të saj. Për këtë arsye, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi e plotëson edhe kriterin e legjitimitit *ratione temporis*.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, përderisa natyra e pretendimit të ngritur nga kërkuesi është vlerësuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve se justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues (*shih paragrafin 11 të këtij vendimi*), ai *prima facie* hyn në juridiksionin e kushtetues dhe do të shqyrtohet në vijim për bazueshmërinë e tij.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike*

14. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi, sipas tij, rekursi i palës së paditur është paraqitur jashtë afatit procedural 30-ditor të parashikuar nga KPC-ja, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka pranuar atë për shqyrtim dhe në vijim ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtat kushtetuese të tij.

15. Në funksion të parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Mospërcaktimi i tyre do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 5, datë 02.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin kur kushtet e paraqitjes së ankimit ose padisë, siç është afati, janë përcaktuar nga ligji, Gjykata ka vënë në dukje rëndësinë kushtetuese që ka zbatimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, me qëllim që individit t'i garantohet procesi i rregullt në aspektet e aksesit në gjykatë dhe të mbrojtjes efektive (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës*

*Kushtetuese*). Respektimi i afatit ligjor për paraqitjen e rekursit lidhet me parimin e sigurisë juridike, i cili, mes të tjerash, garanton qëndrueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si edhe besueshmërinë e individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 2, datë 29.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Po kështu, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrim të kontrollit të kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, Gjykata vlerëson dhe interpreton faktet e çështjes vetëm në funksion të pretendimeve me natyrë kushtetuese, me qëllim vlerësimin prej saj të respektimit të së drejtës së pretenduar të cenuar (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i paraqitur nga pala e paditur, ish-Bashkia Sukth, ndërsa kërkuesi ka paraqitur kundërrekurs, duke pretenduar se rekursi është paraqitur jashtë afatit procedural 30-ditor të përcaktuar nga neni 443 i KPC-së. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi e ka marrë në shqyrtim atë, ka konstatuar se vendimi i gjykatës së apelit rezulton të jetë i datës 21.10.2014, ku pala rekursuese ka qenë në mungesë. Në vlerësimin e Kolegjit Civil, i padituri ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës së apelit nëpërmjet dëftesës së komunikimit nr. 264, datë 18.12.2014, por në të nuk rezulton të jetë e saktësuar data e marrjes dijeni, ndërkohë ka paraqitur rekurs pranë gjykatës së shkallës së parë në datën 06.03.2015. Sipas Kolegjit Civil, edhe pse bashkëlidhur kundërrekursit kërkuesi ka paraqitur kopjen e një padie tjetër, të ngritur në datën 26.01.2015, ku person i tretë ishte ish-Bashkia Sukth, dhe ku ishte cituar vendimi nr. 723 (10-2014-2857), datë 21.10.2014 i Gjykatës së Apelit Durrës, ndryshe nga sa pretendon ai (kërkuesi) nuk rezulton se kur i është njoftuar kjo padi palës së paditur dhe nuk mund të merrej si referencë data e padisë si njoftim i vendimit të apelit, objekt rekursi. Për këtë arsye, Kolegji Civil ka vlerësuar

se rekursi është paraqitur brenda afatit ligjor 30-ditor të parashikuar nga neni 443 i KPC-së dhe plotëson kushtet formale (*shih paragrafin 16 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

19. Ndërkohë, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se me dëftesën e komunikimit nr. 264, datë 18.12.2014, Gjykata e Apelit Durrës i ka dërguar ish-Bashkisë Sukth vendimin e saj nr. 723 (10-2014-2857), datë 21.10.2014. Kjo dëftesë komunikimi rezulton se është nënshkruar nga punonjësi i postës dhe nga shtetasja M.D., por në këtë aktinjoftimi nuk pasqyrohet data e dorëzimit të tij. Nisur nga kjo, nga aktet e dosjes gjyqësore nuk provohet data kur pala e paditur (ish-Bashkia Sukth) ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës së apelit, nga e nesërmja e së cilës, sipas ligjit procedural, për atë ka filluar të ecë afati për paraqitjen e rekursit. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi nuk ka sjellë asnjë provë që të vërtetojë momentin e marrjes dijeni për vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës nga pala e paditur, fakt mbi të cilin të rezultonte i gabuar vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për paraqitjen në afat të rekursit nga ajo palë. Për rrjedhojë, në kushtet kur nuk ka asnjë provë në dosjen gjyqësore dhe as nga kërkuesi nuk është paraqitur një e tillë që të vërtetojë pretendimin e tij për paraqitjen jashtë afatit të rekursit të palës së paditur, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me të drejtë ka vlerësuar paraqitjen në afat të rekursit nga pala e paditur, ndërsa një vlerësim i ndryshëm do të shkaktonte cenimin kësaj pale të së drejtës së aksesit në aspektin e së drejtës së ankimit.

20. Për këto arsye, duke pasur parasysh rëndësinë kushtetuese që ka zbatimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, sidomos nga Gjykata e Lartë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ajo gjykatë ka kryer funksionin e saj në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, duke garantuar për palët një proces të rregullt, në respektim të aksesit në gjykatë dhe të sigurisë juridike. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se Gjykata e Lartë gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesit ka respektuar të drejtat e tij kushtetuese dhe zbatimi i ligjit prej saj nuk ka qenë arbitrar, si dhe as nuk bie ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Për këto arsye, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është haptazi i pabazuar.

21. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.